

VENDIM
Nr.273, datë 18.3.2009

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR TË NDËRTESES “PREFEKTURA SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 3, shkronja “k”, 5 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7867, datë 12.10.1991 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të ndërtesës “Prefektura Shkodër”, sipas formularit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Bashkisë së Shkodrës i ndalohet tjetërsimi ose ndërrimi i destinacionit të pronës, të përcaktuar në këtë vendim. Ajo është institucioni përgjegjës, për ruajtjen e tërësisë së vlerave, kulturore e historike, si monument kulture, të kësaj ndërtese, sipas akteve ligjore e nënligjore, në fuqi.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.
4. Dispozitat e akteve nënligjore, që bien në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohen. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia SHKODER		Identifikimi:		Nedret Qehaja Specialiste topografe (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
Fusha e perdorimit te Prones: Administrative		Supervizori:		Kujtim Domnori Specialist inxhinier (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)		Tel 02243720	
Aprovoli:		Aprovi:		Artan Haxhi Kryetar Bashkie (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			

A			B		C					
Nr. Rend.	Zona Kadastrale & Indeks Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegesi administrative	Institucioni / Enti per dorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
26	8594 M-7	3/160	Nd. Tfuall	Dega e Bankes se Shqperise Shkoder	519	292	Dege e Bankes Qendrore	Banka e Shqperise	Banka e Shqperise	Plese e kalit perdhene godinen e Prefektures
27	8594 M-7	3/270	Nd. Tfuall	Garazh i deges se B.Sh. Shkoder	117	117	Garazh automjeti	Banka e Shqperise	Banka e Shqperise	Ndertesese nje kateshe
28	8591 N-6	1/397*1-1	Nd. Tfuall	Sherbimi Kombetar / Punesimit (Zyra Punes)	466	466	Zyra pune	Ministria e Punes e ceshljeve soc	Ministria e Punes e ceshljeve soc	
29	8591 N-6	1/397*1-3	Nd. Tfuall	Sherbimi Kombetar / Punesimit (Qendra Formimit Profesional)	557	557	Zyra pune	Ministria e Punes e ceshljeve soc	Ministria e Punes e ceshljeve soc	
30	8594 N-7 M-7	3/160 3/237, 3/234 3/235, 3/269	Nd. Tfuall	Prefektura+salla e mbledhjeve+ garazh	5584	2094	Zyra pune	Prefektura	Prefektura	Kati I-re Agj. Trajt Kredive, Kati II-te AKP, Drejt Arsimore, Pol. Nderit, Ent. Banesave, AITPP Kati III-te Prefektura, Kesh Qarkut Dega Buxheit